



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 12, paragrafit 12.2, shkronja “d” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, si dhe nenit 19, paragrafi 1 (pika 1.4) i Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhje e mbajtur më datën **30 mars 2023** merr këtë:

### **V E N D I M**

#### **PËR CAKTIMIN E KAHJEVE NË DISA RRUGË TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

1. Rruga qarkulluese „Weslli Klark” caktohet rrugë me një kahe të lëvizjes në drejtim të rrugës „Ruzhdi Hyseni”.
2. Segmenti i parë i rrugës qarkulluese „Ismail Qemajli” caktohet rrugë me një kahe të lëvizjes, në drejtim të rrugës „Haxhi Zeka”
3. Rruga qarkulluese „Ruzhdi Hyseni” caktohet rrugë me një kahe të lëvizjes në drejtim të rrugës rrugës – sheshit „Hasan Prishtina”.
4. Rruga qarkulluese „Isa Boletini” përcaktohet rrugë me një kahe të lëvizjes nga kryqëzimi me sheshin - rrugën „Hasan Prishtina” në drejtim të rr. „Zenullah Begu”.
5. Në rrugën qarkulluese me një kahe të lëvizjes „Hasan Prishtina” ndalohet ndalja dhe parkimi për mjetet me veprim motorik.
6. Rruga „Ramadan Fazliu” rezervohet për parkimin e taksive individual.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspektimeve e Komunës së Vushtrrisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br 84/23

Nr. i fq. / Br. si -1-

Data / Datum: 30.03.2023

VUSHTRRI - VUČITRAN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" lidhur me nenin 17, pika "s" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1.4. të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 mars 2023**, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR KORRIGJIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRRISË ME NR.01.49/20 I DATËS 27.2.2020**

1. Me këtë vendim korrigohet pika 1.1 dhe 1.2 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01 nr.49/20 i datës 27.2.2020 për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta, ashtu që bëhet korrigjimi i sipërfaqes si në vijim:

- 1.1. Shalë .....19,485.00 ha
- 1.2. Çyqavica.....12,878.67 ha

2. Pjesët tjera të vendimit me numër të protokollit 01.nr.49/20 i datës 27.2.2020 mbesin në fuqi.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: harta për zonën e Shalës dhe zonën e Çyqavicës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtorja për Prokurim dhe Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) dit pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО  
KOMUNA E VUSHTRISË - ОПШТИНА ВУШТРИ

01 Nr./Br: 85/23

No. Fq./Br. i: - 1 -

Data/ Datum: 30. 03. 2023

VUSHTRI - ВУШТРИ



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtri**

Në bazë të nenit 12.2, shkronja “d” në lidhje me nenin 40.2, shkronja “a” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrisë 01. Nr. 209/2022, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 mars 2023** merr këtë:

### **VENDIM**

#### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN (HARTIMIN) E RREGULLORES PËR PUNËN E KUVENDIT DHE ORGANEVE TË TIJ**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshim-plotësimin (hartimin) e Rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij, në përbërjen si në vijim:

- 1.1. **Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e Kuvendit (PDK);**
- 1.2. **Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit (LDK);**
- 1.3. **Mek Selaci, anëtar i kuvendit (LVV);**
- 1.4. **Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit (Nisma Socialdemokrate) dhe**
- 1.5. **Bastri Duraku, nga sekretaria e kuvendit.**

2. Komisioni i cekur në pikën një (1) të këtij vendimi, do të bëjë plotësim-ndryshimin (hartimin) e draftit të kësaj rregulloreje dhe të njëjtën do ta procedojë në kuvend për aprovim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit të cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKI E KOSOVES  
Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Nr. Nr./Më: 86/23

Nr. Që/ Më: - 1 -

Data / Ditë: 30.03.2023

SHËNIMET: - MËSHKURIMET



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit (2009/03-L-025), nenin 19, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke iu përgjigjur kërkesës të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër të referencës 193-2/23 e datës 2.2.2023 për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të komunës Nr.331/23 i datës 29.12.2022, që lidhet me harmonizimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 mars 2023**, merr këtë:

### V E N D I M PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL PËR VEPRIM NË MJEDIS

1. Me këtë vendim miratohet Plani Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2023-2026
2. Për zbatimin e këtij plani obligohen Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Shërbime Publike, Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2023-2026.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin nenit 19, paragrafi 1 (pika 1.4) i Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 mars 2023**, merr këtë:

### VENDIM PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË DËMEVE

1. Me këtë vendim aprovet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën nëntor –dhjetor 2022 dhe janar, shkurt-mars 2023.
2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në teren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (vërshimet, zjarret dhe erërat e forta) që kanë mbretëruar në periudhën e sipër cekur në Komunën e Vushtrrisë.
3. Komisioni i cekur më lartë ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkulua shumat e mjeteve financiare të shkaktuara dëm në vlerë totale prej **110,096.73 €**, si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare, këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).
6. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit